

GANI PLLANA

PROCESE TË TERMINOLOGJIZIMIT NË GJUHË
Konceptimi i terminologjizimit si mënyrë e ngritjes në terma të fjalëve të zakonshme


Terminologjia si nënsistem leksikor special më vete hyn në lidhje me shtresat e leksikut të përgjithshëm të gjuhës dhe këmbëhet me to, duke huazuar një pjesë prej tyre e duke i shfrytëzuar për nevojat e saj. Ky leksik, i ardhur jashtë terminologjisë, përbëhet nga njësi leksikore që hyjnë në të me formë të pandryshueshme, por me *përmbajtje të modifikuar*, duke plotësuar nevojat e sistemeve terminologjike me terma. Procesi i *ngritjes së leksikut të përgjithshëm* në terma, që emërtohet edhe terminologjizim, ka lidhje me bazën burimore semantike të fjalës. Ky proces pasuron terminologjinë jo vetëm në rrafshin e formës, duke u futur në një sistem terminologjik të caktuar, por, kryesisht në atë të përmbajtjes, duke e plotësuar me koncepte, të cilat ruajnë lidhjet me bazën kuptimore të saj (me gjuhën e përgjithshme). *Fjala shfaqet kështu si urë lidhëse ndërmjet leksikut të përgjithshëm dhe atij terminologjik*, si: *bërri*₁, sy (fjalë të zakonshme) dhe terma: *bërri*₁ (rruge), *bërri*₂ (tubi), *bërri*₃ (boshti) etj. Nga ana tjetër, këto njësi, duke kaluar nga njëra fushë e dijes në tjetrën, i pasurojnë ato me përmbajtje konceptore të ndryshme, duke vijuar në një riterminologjizim të njësisë si: *lopatë*₁ (vegël)-*lopatë*₂ (ventilatori)-*lopatë*₃ (përzierëse)-*lopatë*₄ (mekanike). Ndonëse nga pikëpamja e formës, sistemet terminologjike mbingarkohen me forma të njëjta nga ana e përmbajtjes, *njësitë e terminologjizuara rritin bazën e përbashkët konceptore të fjalëve dhe termave*, duke përforcuar kështu aftësinë bashkëvepruese të termave njërin me tjetrin ndërmjet fushave të ndryshme të dijes. E. Vyster (Eugen Wüster), lidhur me dukuri, thekson se: “*shprehja me një shenjë e kuptimeve të fushave të ndryshme ndihmon lidhjen e tyre njëra me tjetrën dhe bën më të lehtë bashkëpunimin e specialistëve të fushave të afërta njëri me tjetrin*”¹ si, p.sh., *dhomë*: *dhomë* (e gazeve) (nd., mek., ushtr.); *rrënjë*₁ (bot., mat., kim., mek., mjek.) etj.

Terminologjizimi, si proces i krijimit të makrosistemit terminologjik mbi bazën e futjes së fjalëve në këtë mikrosistem, duke funksionuar si terma, si edhe *termëzim*, si proces i ngritjes së fjalës në term, të dy së bashku, mund të vështrohen në kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit semantik të fjalës, ku bazën e përbën fjala, që nga kjo pikëpamje *del gjithnjë parësore para termit*. Vlerë të veçantë merr funksionimi i këtyre proceseve në strukturën semantike të fjalës, ku pasqyrohen të lidhura si proceset e termëzimit, terminologjizimit, shterminologjizimit, dhe të gjitha proceset e ndërlikuara të zhvillimit semantik të

¹ E. Wüster, *Einführung in die allgemeine Terminologielehre und terminologische Lexikographie*, 3. Auflage. Romanistischer Verlag, Bonn, 1991.

çdo fjale të gjuhës. Kjo del shumë e rëndësishme gjatë studimit të semantikës së termit në dritën e zhvillimit kuptimor të fjalëve”.

Mjaft fjalë të fondit leksikor me strukturë semantike të gjuhës fitojnë në përmbajtjen e tyre kuptimore dhe kuptime të veçanta terminologjike ndërmjet specializimit dhe përdorimit në një degë të ngushta të shkencës, të teknikës dhe të prodhimit. Këtu, mund të sjellim si shembuj fjalët *krah* e *dhëmb*, ku fjala *krah* ka në strukturën e saj kuptimore 18 kuptime, nga të cilat 3 kuptime kanë karakter special terminologjik: **KRAH~U** m. sh. ~**Ë**, ~**ËT**: 13. *sport*. “lojtari anësor në vijën e sulmit të një skuadre; ana e djathtë ose e majtë e vijës së sulmit (në disa lojërë me top dhe në shah). “*Krahët e skuadrës së futbollit*”. 14. *tek*. “pjesa e dalë dhe e lëvizshme e një mekanizmi, e një vinçi, e një ekskavatori etj. *Krahu i vinçit (i ekskavatorit)*. 5. “Secila nga fletët e aeroplanit, që e mbajnë atë në ajër gjatë fluturimit: fletët. Aeroplan me dy palë krahë”. Fjala “*dhëmb*” ka në strukturën e saj kuptimore dy kuptime, nga të cilat një kuptim ka karakter special terminologjik por të lidhur në formë të zbërthyer me një varg konceptesh terminologjike, të pasqyruara nga terma përkatës togfjalësh: **DHËMB**, ~**I** m. sh. ~**Ë**, ~**ËT**. 2. *kryes. sh.* “varg pjesësh të dala, zakonisht të mprehta ose me majë, në një vegël, në një send tjetër; dhëmbëz; fije e hollë kallami, teli a metali e krehrit të tezgjahut. *Dhëmbë të hekurt (të çeliktë). Dhëmbët e sharrës (e frezës, e ingranazhit). Dhëmbët e krehrit. Rrotë (lesë, frezë) me dhëmbë*”. Duke qenë fjalë të zakonshme të ngritura në terma këto fjalë e kanë më të lehtë të futen në përdorim më të gjerë në gjuhë dhe të afrohen me leksikun e përgjithshëm të saj. Karakteristikë e gjuhës shqipe është që këto fjalë terma pasi hyjnë në leksikun terminologjik kanë aftësi të vihen në lidhje më të gjera fjalëformuese². Kështu fjala “*gur*” në kuptimin e vet terminologjik *gur*₁(themeli)-*gur*₂(kyç)-*gur*₃(gëlqereje) krijon lidhje fjalëformuese në kuptimin terminologjik si *guror-e-gurthyese*, çka mund të shihet në paraqitjen e lidhjeve termformuese të mëposhtme:



2. Studimet terminologjike rreth terminologjizimit

Rreth problemit të terminologjizimit janë shkruar një varg studimesh, në të cilat është theksuar vendi dhe roli që luajnë fjalët e zakonshme të

² A. Shumeli, *Formimi dhe funksionimi i terminologjisë së agromekanikës në shqipe në përqasje me anglishten*, dis., Tiranë, 2013, f. 65.

shumëkuptimshme të tipit *pikë, dhëmb, kokë, këmbë, xhep* etj., për krijimin e termave. Duke trajtuar problemin e formimit të termave të rinj, A. Duro në punimin “*Lindja dhe përhapja e termave në gjuhë*”³, thekson se termi futet më lehtë në përdorim, kur është ngritur në term nga një fjalë e zakonshme, kur ajo përdoret me kuptimin e specializuar të saj në një fushë të caktuar të dijes ose të veprimtarisë njerëzore. Si shembuj autori sjell fjalë të ngritura në terma si *kokë* (buloni), *dhëmb* (rote), *krah* (leve), *dritare* (e jashtëqitjes): etj. Në fushën e gjuhësisë Sh. Rrokaj dhe V. Bello⁴, krahas trajtimit të problemeve të përgjithshme të terminologjisë gjuhësore, i kushtojnë rëndësi problemit të terminologjizimit, ku shënojnë se “*sistemi terminologjik i gjuhësisë i ndërtuar në këtë mënyrë mbështetet në brumin e shqipes, duke bërë më të lehtë formimin e tij*.”

Sipas Sh. Demiraj⁵, S. Frashëri ka përdorur shumë fjalë të tabanit të shqipes për të shënuar terma diturakë, shkencorë ose politiko-administrativë. Duke trajtuar çështjen e formimit të termave në fushën e ekonomisë, H. Pasho⁶ sjell shembuj të përdorimit të fjalëve të zakonshme “*krah*” dhe “*degë*” në kuptimet e reja terminologjike si “*krah pune*” dhe “*degë banke*”, duke nënvizuar faktin se fjalori i 1980-ës “*e ka ndjekur këtë vijë afrimi ndërmjet terminologjisë së ekonomisë e leksikut të gjuhës së përgjithshme edhe nëpërmjet pasqyrimit të një vargu termash të shqipëruar, duke ndihmuar të nxirren jashtë gjuhe një varg termash të huaj*”⁷.

3. Shfaqje të terminologjizimit të pasqyruar në fjalorët filologjikë

Kuptimet e termave të ngritur mbi bazën e kuptimeve të fjalëve të zakonshme gjejnë pasqyrim në fjalorët shpjegues të shqipes në strukturat semantike të fjalëve të tyre. Studimi i këtyre kuptimeve të fjalëve, kur shfaqen si terma si *këmbë* (fjalë) dhe *këmbë* (term) e që veçohen si të tillë gjatë përdorimit në fushën përkatëse të dijes, jep mundësi të shqyrtohet ky shtresim ndërmjetës leksikor në lidhje me leksikun e përgjithshëm, me grupet e tjera të leksikut terminologjik, ashtu edhe me rastet e funksionimit në praktikën ligjërimore të çdo fushe⁸.

Nga shqyrtimi që u është bërë grupeve të ndryshme të termave në fjalorët shpjegues vërehet se marrëdhëniet e leksikut terminologjik teknik me gjuhën e përgjithshme nga njëri fjalor në tjetrin, qysh nga fjalori i 1954-ës deri tek fjalori i 1980-ës, nga ana e zhvillimeve semantiko-leksikore kanë ardhur duke u ndërlikuar, por herë-herë edhe duke u diferencuar më mirë ndërmjet tyre. Dukuria

³ A. Duro, *Lindja dhe përhapja e termave në gjuhë*, në “Gjuha jonë”, nr. 2, Tiranë, 1981, f. 40-50.

⁴ Sh. Rrokaj, V. Bello, *Mbi domosdoshmërinë e një fjalori të termave të gjuhësisë në gjuhën tonë*, Konferencë shkencore “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe-probleme dhe detyra”, Tiranë, 2009. f. 168-178.

⁵ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe-Probleme dhe disa figura të shquara të saj*, Tiranë, 2003, f. 222.

⁶ H. Pasho, *Përdorimi i termave të ekonomisë*, “Gjuha jonë”, nr. 2, Tiranë, 1982, f. 33-38.

⁷ H. Pasho, *Zhvillimi i terminologjisë së ekonomisë pas Çlirimit dhe pasqyrimi i saj në dy fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe*, në “Studime filologjike”, nr. 1, Tiranë, 1984, f. 49-72.

⁸ A. Duro, *Terminologjia si sistem*, Panteon, Tiranë, 2001, f. 21.

e ndërlikimit lidhet me shtimin e kuptimeve (koncepteve) të reja terminologjike, të lidhura pas një shenje, çka ka të bëjë me dukurinë e terminologjizmit, ku ky i fundit del edhe me anën negative (shtohen konceptet, por shenjat mbeten po ato), por edhe me shtimin e vetë termave të rinj, të krijuar me rrugën e termformimit, ku shtohen shenjat krahas koncepteve, ku shenjat pasurojnë realisht sistemet terminologjike. Në lidhje me zhvillimin e këtyre dy proceseve në çdo terminologji, duhet nënvizuar se procesi i terminologjizimit ka mbizotëruar para formimit të termave të rinj me rrugën e prejardhjes, ku në këtë të fundit formimi i termave të rinj frenohet herë pas herë për shkak të marrjes mbi vete nga shenjat ekzistuese, të shprehjes si koncepte të reja në procesin e terminologjizimit, siç kemi përmendur më sipër, si *gisht*, *xhep*, *kokë*, *dhëmb* etj. Megjithatë mund të vërehet se qysh nga Fjalori i vitit 1954, terminologjizmi ka ecur krahas termformimit (formimit të termave të rinj) dhe nisur nga kjo rrethanë mund të bëhen analiza lidhur me këto dy procese, duke u mbështetur në lëndën tërësore të fjalorëve të shqipes. Këtu, duhet nënvizuar, se, vështruar nga ana e terminologjizmit, “Fjalori i 1980-tës” shërben si bazë analize edhe për termat e teknikë, meqë në ta zbërthehet më e detajuar struktura semantike e çdo fjale dhe brenda saj zbulohen më qartë kuptimet e veçuara terminologjike, ashtu edhe rastet e kalimit nga njëri kuptim në tjetrin (nga kuptimi i zakonshëm në atë terminologjik dhe anasjelltas). Prandaj ky *Fjalor* ka shërbyer dhe shërben si bazë për një analizë të gjerë të marrëdhënieve që vendosen midis fjalëve të zakonshme të termave dhe termave të krijuar mbi bazën e kuptimit të tyre⁹.

Më poshtë po paraqesim grupet e termave të formuar mbi bazën e kuptimeve të fjalëve të zakonshme, të paraqitur në Fj. 1980 dhe që lidhen me elemente të ndryshme të jetës së zakonshme, si me objekte, dukuri, procese etj. Kështu përdoren si terma në teknikë e teknologji fjalë të përgjithshme që shënojnë: (1) *terma të ngritur mbi kuptime fjalësh që shënojnë pjesë të trupit të njeriut*: *trup₁* (vidhe) (mek.), *trup₂* (anijeje) (det.), *ballë₁* (galerie) (min.), *ballë₂* (pistoni) (mek.), *vesh* (dadoje) (mek.), *hundë₁* (çekani) (mek.), *hundë₂* (dize) (mek.) etj., të cilat do t'i trajtojmë në këtë punim.


4. Terma të ngritur mbi kuptim fjalësh që shënojnë pjesë të trupit të njeriut

Fjalët që shënojnë pjesë të trupit të njeriut kanë përhapje të gjerë në procesin e kalimit nga fjalë me kuptime të zakonshme në fjalë me përdorim të specializuar në fushat e ndryshme të shkencës e të teknikës. Konceptet që shënojnë këto fjalë futen në sistemin e koncepteve të fushës së dhënë, duke zgjeruar e pasuruar më tej lidhjet ndërmjet tyre. Aftësia e këtyre fjalëve të zakonshme për të krijuar terma, lidhet me anën e përafërt që ka fjala me formën e funksionin e saj me konceptin që kërkohet të shënjohej. Kështu kuptimi i fjalës *krah₁* (i njeriut) nga forma e

⁹ A. Shumeli, *Disa shënime mbi terminologjinë e agromekanikës në Fjalorin e 1980-ës*, në “Kërkime gjuhësore”, vëll. II, Konferencë shkencore ndërkombëtare mbajtur më 4 korrik 2013, Tiranë, QSA IGJL, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2014, f. 41-48.

Procese të terminologjizimit në gjuhë...

funkcioni që kryen ngjason me *krahun* (*e vinçit*), si koncept i ri, ndaj edhe emërtimi *krah₂* (i njeriut) i vishet konceptit që kërkohet të shënjohe.



Në vazhdim do të paraqesim rastet e fjalëve të zakonshme, *pjesët e trupit të njeriut*, të cilat përmes procesit të terminologjizimit ngrihen në fjalë me kuptim të specializuar, në terma, të pasqyruar në *Fj. 1980* dhe të konkretizuar si shënues kuptimesh në terminologjitë e fushave teknike, duke dhënë në mënyrë të koduar edhe burimin ku është përdorur fjala për herë të parë.

Në Fj. 1980	Në Fj. terminologjikë
TRUP , ~ I m. sh. ~A, ~AT. 1. fiz. Çdo qenie, send, lëndë a pjesë e saj, me tipare e me veti të ndryshme dhe në trajta të ndryshme, që zë një vend të caktuar në hapësirë; send lëndor. <i>Trup i ngurtë (i lëngët, i gaztë). Trup i thjeshtë (i përbërë). Trup elastik (plastik). Lëvizja e trupave. Peshë e trupave. Vetitë e trupave. Temperatura e trupit. Anatomia e trupit të njeriut. Lartësia (gjatësia) e trupit. Trupi i vidhës. Trupi i plugut. Trupi i aeroplanit (i anijes). Trupi i motorit (i tornos).</i>	<i>trup₁ (vidhe) (mek.)</i> <i>trup₂ (anijeje) (det.)</i> <i>trup₃ (motori) (mek.)</i> <i>trup₄ (rrrotullim) (viz. tek.)</i>
KOK/Ë , ~ A f.sh. ~Ë, ~ËT edhe ~ A, ~ AT. 1. Pjesa e sipërme e trupit të njeriut që qëndron mbi qafën ose pjesa e përparme a e sipërme e trupit të kafshëve, e rumbullakët a e zgjatur, ku ndodhen truri, goja, sytë, veshët, hunda, flokët etj. <i>Me kokë të madhe (të vogël). Kokë njeriu. Kokë dashi (viçi, kali, majmuni, peshku, gjarpri). Kafka e kokës. Në majë të kokës. Koka e gozhdës. Koka e gjilpërës. Koka e pusit.</i>	<i>kokë₁ (buloni) (mek.)</i> <i>kokë₂ (filetëprerëse) (mek.)</i> <i>kokë₃ (frezuese) (mek.)</i> <i>kokë₄ (vidhe) (mek.)</i>
FLOK , ~ U m. sh. ~ Ë, ~ËT. 1. Secila nga qimet e kokës së njeriut; sh, tërësia e këtyre qimeve. <i>Flokë të zinj (të verdhë, të thinjur). Flokë kaçurrelë. Flokë të ashpër (të butë). Flokë të dendur (të rrallë). Qime floku. Shtegu i flokëve. Kapëse flokësh. Kreh flokët.</i>	<i>flokë (strukture derdhjeje) (met.)</i>
BALL/Ë , ~ I m. 1. Pjesa e sipërme e fytyrës së njeriut midis syve dhe	<i>ballë₁ (galerie) (min.)</i>

GANI PLLANA

flokëve; pjesa e sipërme e turirit të shtazëve. <i>Ballë i lartë (i gjerë, i ngushtë). Ballë i dalë (i futur).</i> Balli i ujit. Balli i galerisë (i tunelit, i pusit). Balli i punimit. Ballë kërkimi.	<i>ballë₂ (pistoni)</i> (mek.) <i>ballë₃ (rrahësi)</i> (mek.)
VESH , ~ I m. sh. ~ Ë , ~ ËT . 1. Secili nga dy organet e dëgjimit, që gjenden në të dy anët e kokës te njeriu dhe te kafshët e larta; pjesa e jashtme prej kërceje, llaça e këtyre organeve. Veshi i njeriut. <i>Veshi i shtambës (i poçes). Kazan (tenxhere) me veshë. Veshë të metaltë. Veshët e mashës. Veshët e sfurkut. Tjegulla me veshë.</i>	<i>vesh₁ (plugu)</i> (bujq.) <i>vesh₂ (sfurku)</i> (bujq.) <i>vesh₃ (dadoje)</i> (mek.)
SY , ~ RI m. sh. ~, ~ TË . 1. Organi i të parit te njeriu dhe te kafshët, që ndodhet në pjesën e përparme të kokës ose anash saj. Kapakët e syve. Zgavra (gropa) e syrit. Nervi i syrit. Cepi (bishti) i syrit. <i>Syri i litarit. tek. Vrimë e rrumbullakët ku futet një vegël a një pjesë tjetër. Syri i pistonit (i boshtit).</i>	<i>sy₁ (magjik)</i> (anat.) <i>sy₂ (laku)</i> (mek.) <i>sy₃ (pistoni)</i> (mek.)
HUND/Ë , ~ A f. sh. ~ Ë , ~ ËT . 1. Organi i nuhatjes; pjesë e dalë e fytyrës mbi gojë e nën sy, me dy vrima, nëpër të cilat kalon ajri gjatë frymëmarrjes. <i>Maja e hundës. Hunda e anijes (e vaporit, e lundrës). Hunda e malit (e shkëmbit). Hunda e çekanit. Hunda e plorit.</i>	<i>hundë₁ (anijeje)</i> (det.) <i>hundë₂ (çekani)</i> (mek.) <i>hundë₃ (dize)</i> (mek.)
FLEG/ËR , ~ RA f. sh. ~ RA , ~ RAT . 1. Secili nga dy kapakët a kanatet e derës, të dritares etj.; fletë. <i>Flegër dere (dritareje). Derë me dy flegra. Copë e hollë e diçkaje, thellë, riskë; ashkël. Flegër molle (pjepri). Flegër sapuni. Flegër pishe.</i>	<i>flegër₁ (dritareje)</i> (nd.) <i>flegër₂ (valvole)</i> (mek.)
GOJ/Ë , ~ A f. sh. ~ Ë , ~ ËT . 1. Organ në pjesën e poshtme të fytyrës së njeriut, midis hundës e mjekrës, që ka nofullat me zgavrën ndërmjet tyre e faqeve, dhëmbët, gjuhën e buzët nga ana e jashtme dhe që shërben për të ngrënë e për të pirë, për të marrë frymë e për të folur. <i>Goja e shpellës. Goja e furrës. Goja e tunelit. Goja e vullkanit krateri. Goja e sqeparit. Goja e dërrasës. Goja e fishekut. usht.</i>	<i>gojë₁ (furre)</i> (mek.) <i>gojë₂ (vullkani)</i> (min.) <i>gojë₃ (dërrase)</i> (nd.) <i>gojë₄ (fisheku)</i> (usht.) <i>gojë₅ (tubi)</i> (usht.)
BUZ/Ë , ~ A f. sh. ~ Ë , ~ ËT . 1. Secila nga dy pjesët e mishta e të lëvizshme, zakonisht ngjyrë trëndafili, që mbulojnë dhëmbët dhe që kufizojnë e mbyllin gojën nga jashtë, duke u bashkuar në të dy anët e saj në pjesën e poshtme të fytyrës. <i>Buza e sipërme (e poshtme). Buzët e tryezës. Buza e vatrës. Buzët e gotës. Buzët e gjethes (e lules). Buza e brskut. Buza e rrugës (e shkëmbit, e greminës).</i>	<i>buzë₁ (ene)</i> (mek.) <i>buzë₂ (rruge)</i> (nd.) <i>buzë₃ (morse)</i> (mek.)
DHËMB , ~ I m. sh. ~ Ë , ~ ËT . 1. Secila nga eshtrat e vogla të ngulitura thellë në të dyja nofullat, që i shërbejnë njeriut ose kafshës për të copëtuar e për të përtypur ushqimet ose për të kafshuar diçka. <i>Dhëmbë të mprehtë (të fortë). Dhëmbët e sharrës (e frezës, e ingranazhit). Dhëmbët e krehrit. Rrotë (lesë, frezë) me dhëmbë.</i>	<i>dhëmbë₁ (rrrote)</i> (mek.) <i>dhëmbë₂ (krehri)</i> (bujq.) <i>dhëmbë₃ (lese)</i> (bujq.)
GRYK/Ë , ~ A f. sh. ~ Ë , ~ ËT dhe ~ A , ~ AT . 1. sh. ~ Ë , ~ ËT . Pjesa e sipërme e gypit nëpër të cilin kalon ushqimi nga goja në stomak, pjesa e prapme e gojës që lidhet me gypin e ushqimit dhe të frymëmarrjes; pjesa e përparme e qafës; fyt. <i>Gryka e shishes. Gryka e gjymit. Gryka e pusit pjesa e sipërme e pusit, e rrethuar me mur. Gryka e vullkanit. Gryka e pushkës (e topit, e çiftes).</i>	<i>grykë₁ (pusi)</i> (min.) <i>grykë₂ (vullkani)</i> (gjeol.)
QAF/Ë , ~ A f. sh. ~ A , ~ AT . 1. Pjesë e trupit të njeriut dhe të kafshëve që bashkon kokën me trungun. <i>Qafë e gjatë (e shkurtër, e hollë, e trashë). Qafa e njeriut. Qafa e kalit (e lopës, e patës, e gjarprit). Qafa e gozhdës. Qafa e furkës.</i>	<i>qafë₁ (buloni)</i> (mek.) <i>qafë₂ (boshti)</i> (mek.) <i>qafë₃ (tubi)</i> (mek., nd.)
SUP , ~ I m. sh. ~ Ë , ~ ET . 1. Pjesa e trupit të njeriut nga rrëza e qafës deri te cepi ku lidhet krahë me trungun; skaji i sipërm i shpatullave. <i>Supi i djathtë (i majtë). Me supe të rëna. Mban mbi supe. Hodhi pushkën (lopatën, kazmën) në sup. I vjen deri në sup. E preku në sup. Sup- armë! Usht. Komandë! Usht. Komandë për të hedhur armën të mbështetur drejt në anë të gjoksit duke e mbajtur nën qytë vetëm me</i>	<i>sup (ngritësi)</i> (mek.)

Procese të terminologjizimit në gjuhë...

dorën e thyer.	
SHPATULL , ~ A f. Sh. ~ A , ~ AT. 1. Anat. Secila nga të dy kockat e gjera, rrasike e si trekëndësh, që janë djathtas e majtas pjesës së sipërme të shpinës së njeriut; <i>zakon. Sh.</i> Pjesa e shpinës rreth këtyre kockave; pjesa e trupit të kafshëve me katër këmbë, ku lidhet këmba e përparme me trupin; kocka e kësaj pjese. <i>Shpatulla e djathtë (e majtë).</i>	<i>shpatull₁ (ure)</i> (nd.) <i>shpatull₂ (mbështetësi)</i> (mek.)
KURRIZ , ~ I m. 1. Pjesa e prapme e trupit të njeriut që nga qafa e supet deri te mesi; pjesa e sipërme e trupit të kafshës gjatë shtyllës kurrizore deri te vithet; shpinë. <i>Me kurriz të drejtë (të kërrusur). Shtrirë në kurriz. Shtylla kurrizore. Kurrizi i karrigës (i kolltukut).</i>	<i>kurriz (peshku)</i> (mek.)
RRUDHË , ~ A f. Sh. ~ A , ~ AT. 1. Vijë e përrhyer në lëkurën e ballit të fytyrës, të duarve etj. Që bëhet kur mblidhet lëkura nga mosha, nga dobësimi, nga vuajtjet a nga një ndjenjë e rëndë; zhubër. <i>Rrudhë e vogël (e madhe, e hollë, e trashë, e thellë, e gjerë).</i>	<i>rrudhë (llamarine)</i> (mek.)
TEJZ/Ë , ~ A f. Sh. ~ A. 1. Anat. Dell a damar i hollë, <i>gilcë; pejzë. Tejzat e gjymtyrëve. Tejzat e zërit.</i> Në të gjitha tejzat e trupit. Teli i buzikut. Gjalmë i hollë prej leshi.	<i>tejzë (kabloje)</i> (el.)
KRYQ , ~ I m. Sh. ~ Ë , ~ ET. 1. Figurë që bëhet nga dy vija, shufra etj., të cilat presin njëra- tjetrën në mënyrë të tillë që të formohen katër kënde të drejta. <i>Bëj një kryq. Në formë kryqi. Zbukurim me kryqe. Kryq i drunjtë (i hekurt, i gurtë, i mermertë). Rrugë kryq. Kryqëzim rrugësh, udhëkryq.</i>	<i>kryq₁ (mekanizmi)</i> (mek., nd.) <i>kryq₂ (rruge)</i> (nd.)
BRINJË , ~ a f. Sh. ~ Ë , ~ ET. 1. Anat. Eshtë e trupit të njeriut dhe të kafshëve të mëdha, e gjatë, e ngushtë dhe e kthyer si hark, që del nga boshti i kurrizit e shkon deri te kocka e krahavorit. <i>Brinja e djathtë (a majtë, e poshtme).</i> Skaji a ana e ngushtë e një sendi, buza; pjesa anësore e një sendi, faqja anësore. <i>Brinja e anijes (e lundrës).</i>	<i>brinjë, (anijeje)</i> (det.) <i>brinjë, (radiatori)</i> (mek.)
DORË , ~ A f. Sh. DUAR, DUART. 1. Secila nga dy gjymtyrët e sipërme të njeriut, që nga supi deri te gishtat; pjesa e fundit e këtyre gjymtyrëve që nga kyçi, e cila ka pëllëmbën e pesë gishtat dhe shërben për të prekur për të kapur, për të marrë sendet, për të bërë punë e veprime të tjera. <i>Dora e djathtë (e majtë).</i>	<i>dorë₁ (kapëse)</i> (mek.) <i>dorë₂ (manipulatori)</i> (rob.)
GISHT , ~ I m. Sh. ~ A , ~ AT dhe ËRINJ, ËRINJTË. 1. Secili prej pesë zgjatimeve të lëvizshme në fund të çdo dore ose të çdo këmbë të njeriut; zgjatime të duarve të njeriut. <i>Gisht i shkurtër (i gjatë, i hollë, i trashë). Gishti i madh (i vogël, i mesëm).</i> Tek. Pjesë e një mekanizmi, që ka trajtën e një kunji të kthyer në majë. <i>Gishti i autokombajnës. Gishti prej çeliku.</i>	<i>gisht₁ (valvule të autokombajnës)</i> (bujq.) <i>gisht₂ (pistoni)</i> (mek.)
GRUSHT , ~ I m.sh. Ë, ËT. 1. Dora me gishtërinj të mbledhur fort, dora e mbyllur dhe e shtrënguar. Shtrëngoj (hap) grushtin. <i>Nderoj (përshëndet) me grusht. I ra me grusht. Goditje me dorë të mbyllur e të shtrënguar; forca e kësaj goditjeje. Grusht i fuqishëm (i rëndë).</i>	<i>grusht₁ (hidraulik)</i> (mek.) <i>grusht₂ (kthimi)</i> (mek.)
BËRRYL , ~ I m.sh. Ë, ËT. 1. Vendi ku përthyeret krah, ana e jashtme e nyjës ku lidhet llëra me pjesën e poshtme të krahut; pjesë e mëngës së një rrobe, që mbulon këtë vend të krahut. <i>Mbështetem (ngrihem) mbi bërryla. Vë bërrylat. I bie (e shtyj) me bërryl. I dolën bërrylat. Çau rrugën me bërryla. Përvesh mëngët deri në bërryl. Arnoi (qepi) bërrylin.</i>	<i>bërryl₁(tubi)</i> (nd., mek.) <i>bërryl₂(boshti)</i> (mek.)
KRAH , ~ U m.sh. Ë, ËT. 1. Secila nga dy gjymtyrët e sipërme të trupit të njeriut nga supi deri te dora; mënga e një veshjeje ku futet secila nga këto gjymtyrë. <i>Krahu i djathtë (i majtë). Me krahë të gjatë (të shkurtër). Krah për krah. Me krahë hapur. Në një krah.</i>	<i>krah₁(ekskavatori)</i> (nd., mek.) <i>krah₂(vinçi)</i> (nd., mek.) <i>krah₃(kriku)</i> (mek.)
GJU-RI m.sh. Ë, ËT. 1. Kyçi i këmbës ku lidhet kofsha me	

GANI PLLANA

kërcirin, vendi ku thyhet në mes këmba e njeriut dhe e kafshëve të mëdha; pjesa e pantallonave, që vjen përpara këtij kyçi. <i>Gjuri i majtë (i djathtë). Gjunjët a pantallonave. Kupa (kaçka) e gjurit.</i>	<i>gju (boshti) (mek.)</i>
KYÇ , ~ I m. Sh. ~ Ë , ~ ET. 1. Mjet prej metali që varet në dy hallka e shërben për të mbajtur të mbyllur një derë, një dollap, një arkë etj.: dry. <i>Kyç varës. E mbyll me kyç. I vë derës (dollapit) një kyç. E ka (është) me kyç. I vë kyçin derës.</i> Anat. Vendi ku lidhen dy eshtra, nyja e eshtrave. <i>Kyçi i dorës (i këmbës). Kyçet e gishtërinjve.</i>	<i>kyç₁ (mbyllës) (nd.)</i> <i>kyç₂ (lidhjeje) (mek., el.)</i> <i>gur kyç₃ (nd.)</i>
KOFSH/Ë , ~ A f. Sh. ~ Ë , ~ ET. 1. Pjesa e këmbës së njeriut ose të kafshës nga këllku deri te gjuri. <i>Kofsha e djathtë (e majtë). Kofshë të trasha (të mbushura, të holla). Kofshë e pjekur. Kofshë viçi (qengji, pule). Një kofshë mish. Muskuj e kofshëve. Rrëzë kofshës.</i>	<i>kofshë (topi) (usht.)</i>
KËMB/Ë , ~ A f. Sh. ~ Ë , ~ ET. 1. Secila nga të dyja gjymtyrët e poshtme të trupit të njeriut; secila nga gjymtyrët e poshtme të trupit të një kafshe a të një shpendi që u shërbejnë atyre për të qëndruar, për të ecur a për të lëvizur; pjesë nga kjo gjymtyrë. Këmba e djathtë (e majtë). <i>Këmbët e përparme (e prapme). Këmbë të trasha (të holla, të shtrembra, të gjata). Këmbët e karriges (e tryezës, e dollapit, e avlëmendit, e shtratit). Këmbët e urës. Këmba e parmendës.</i>	<i>këmbë₁ (motori) (mek.)</i> <i>këmbë₂ (ure) (nd.)</i> <i>këmbë₃ (minerali) (min.)</i>
SHPUT/Ë , ~ A f. Sh. ~ A , ~ AT. 1. Faqja e poshtme e këmbës së njeriut ose të disa kafshëve, që nga majat e gishtave deri te thembra, e cila mbështetet në tokë; shuall i këmbës, tabani. <i>Shputat e këmbëve. Shputë ariu këmbë e madhe. Shkel me gjithë shputën.</i>	<i>shputë (shtylle) (nd.)</i>
ZEM/ËR , ~ RA f. Sh. ~ RA , ~ RAT. 1. Anat. Organi qendror i sistemit të qarkullimit të gjakut te njeriu dhe te kafshët, në trajtën e një koni muskolor me majë poshtë, që gjendet në anën e majtë të zgavrës së krahavorit, në mes të mushkërive; pjesa e majtë e krahavorit, nën të cilën gjendet ky organ; ky organ i disa kafshëve që përdoret si ushqim. <i>Zemër e shëndoshë (e sëmurë). Zemër artificiale. Zemra e njeriut (e lopës, e kalit). Muskujt e zemrës. Barkushet e zemrës. Rrahjet e zemrës. Sëmundjet e zemrës. Operacion në zemër. Bar në zemër. Zemra viçi (qengji) të skuqura. I rrihte zemra. S'i punon (i pushoi) zemra. E mori plumbi në zemër. I ka zënë zemra dhjamë. E mbante (e vuri) dorën në zemër. E shtrëngoi në zemër.</i>	<i>zemër (druri) (pyll.)</i> <i>zemër (forme) (met.)</i> <i>zemër (kablloje) (el.)</i>
ZORR/Ë , ~ A f. Kryes. Sh. ~ Ë , ~ ET. 1. Anat. Pjesë e aparatit tretës të njeriut a të kafshëve, në trajtën e një gypi të mishtë, të gjatë e të ngushtë, që fillon nga stomaku, përdridhet disa herë në bark e mbaron në të ndenjurat. <i>Zorrë prej llastiku. Zorra e ujit. Ujit me zorrë. E zbrazi (e thithi) me zorrë.</i>	<i>zorrë (uji) (mek., nd., bujq.)</i>
BAR/K , ~ KU m. Sh. ~ QE , ~ QET. 1. Pjesa e trupit të njerëzve a të kafshëve, ku janë stomaku, zorrët, mëlçia e zezë dhe organe të tjera; pjesa e trupit të qenieve të gjalla nga gjoksi e poshtë, e kundërta me kurrizin. Sipërfaqja e përkulur dhe e harkuar e një sendi, faqja e fryrë e tij; pjesa e fryrë dhe e rrumbullakët e një ene, e një voze etj. <i>Barku i anijes. Barku i oxhakut. Sharrë me bark. Lëshon (nxjerr, jep, bën) bark. I vë shishet bark më bark..</i>	<i>bark₁ (sharre) (mek.)</i> <i>bark₂ (furre) (mek.)</i> <i>bark₃ (ure) (nd.)</i>

PËRFUNDIM

Duke zbërthyer më tej sipas Fjalorit të gjuhës shqipe (1980) kuptimet e fjalëve që shërbejnë si bazë për termat mund të evidentojmë (zbulojmë) kuptime të tjera në krahasim me kuptimet që paraqiten në strukturën semantike të fjalës. Nga pikëpamja e konceptimit të fjalëve në suazën e terminologjisë, si *kokë*, *krah*, *trung*

etj., mund të nxirret si përfundim, se polisemia e tyre del si homonimi¹⁰, si, p.sh.: tek *krah₁* (zogu), *krah₂* (aeroplani), *krah₃* (vinçi) etj. Largësitë kuptimore (konceptore) ndërmjet njësive *krah_{1,2,3}* janë aq të diferencuara, saqë ndihen si tre objekte (koncepte) të ndryshme.

Analiza e mëtejshme e grupeve të fjalëve, kuptimet e të cilave shërbejnë për krijimin e termave në fushat e ndryshme të dijes, ndihmon në punën për hartimin si të fjalorëve terminologjikë, ashtu edhe të fjalorëve shpjegues të gjuhës. Në mënyrë të veçantë kjo ndihmon për një diferencim më analitik të kuptimeve, si edhe për përcaktimin e kufijve më të drejtë dhe më të motivueshëm ndërmjet termave njëfjalësh dhe atyre togfjalësh, ku, këto të fundit, kanë si bazë zbërthimi termin njëfjalësh të shumëkuptimshëm, siç janë përmendur më sipër fjalët e tipit *pikë*, *krah*, *këmbë* etj.

BIBLIOGRAFI

- A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe (në rrafshin e formës dhe të përmbajtjes)*, QSA IGJL, Tiranë, 2009.
- A. Duro, *Terminologjia si sistem*, Panteon, Tiranë, 2002.
- A. Shumeli, *Formimi dhe funksionalizimi i terminologjisë së agromekanikës në shqipe në përqasje me anglishten*, dis., Tiranë, 2013.
- Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1980.
- M. Samara, *Leksiku politiko-shoqëror në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.
- Th. Feka, *Vëzhgime mbi leksikun terminologjik në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980)"*, në "Studime filologjike", nr. 2, Tiranë, 1986.

¹⁰ Xh. Lloshi, *Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe*, në "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", Tiranë, 1972, f. 203-236.

